

SHËRBIME PROJEKTIMI PER PROJEKTIN TEKNIK DHE MARRJEN E LEJES SE
NDERTIMIT PER NDERTESAT NJESI BANIMI (PALLAT) NE PERPUTHJE ME PDYV-NE E
ZONES THUMANE", NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANE, BASHKIA KRUIJE

VENDODHJA

PDYZH - Thumane njesite e banimit pallat janë pozicionuar ne zonën TH-UB-18,TH-UB-28 dhe TH-UB-34.

QELLIMI

Fondi Shqiptar i Zhvillimit nëpërmjet Programit te Rindërtimit te Zonave te Dëmtuara nga tërmeti ka si

qëllim strehimin dhe akomodimin e familjeve te demtuara nga termeti si dhe përmirësimin e ndërtimit te

shtëpive/banesave dhe objekteve te tjera ne mënyrën me te sigurte duke projektuar dhe ndërtuar me

standartet ndërkombëtare dhe duke sjelle një zbatim efektiv te kodeve te ndërtimit për te akomoduar ne

shtëpitë e reja familjet e dëmtuara nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019.

Synimi i ketij investimi eshte akomodimi i familjeve te pastreha te dëmtuara nga tërmeti i 26 Nentorit

2019, duke patur si objektiv ndertimin e njësive te banimit (pallate), me sipërfaqet e kerkura, me standartet optimale ne nje kohe me te shpejte te mundeshme, ne përputhje me standartet më të larta të

mundshme me parimin “Nderto Perseri me Mire” mbështetur në përcaktimet e secilit plan territorial